

Vendim nr. 29 datë 16.04.2024

(V-29/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.04.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 26 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: ELDA DINAJ, përfaqësuar nga avokat Ermir Beta, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Altin Dumani dhe Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 137, datë 23.03.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrit nr. 62, datë 26.04.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2023-1310, datë 27.07.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 41, 42 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit shtesë të saj; nenet 32 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e kallëzimit të datës 22.02.2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 30, datë 24.02.2023 për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara respektivisht nga nenet 260, 257/a dhe 287 të Kodit Penal (*KP*) ndaj një deputeti. Në datën 17.03.2023 është vendosur regjistrimi i këtij shtetasi si person nën hetim, i dyshuar për kryerjen e këtyre veprave penale.

2. Në kuadër të këtij procedimi Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) me kërkesë me objekt caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, për dy pasuri të paluajtshme, një prej të cilave, një vilë dhe një sipërfaqe toke, e ndodhur në kompleksin “Green Coast” në fshatin Palasë, Vlorë. Kjo pasuri rezulton të jetë porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. 3100 rep. dhe nr. 1660 kol., datë 16.08.2018 nga shoqëria “Inerte Express” sh.p.k. me administrator M.B. e më pas, me kontratën nr. 1382 rep., dhe nr. 1010 kol., datë 13.04.2021, i ka kaluar të drejtat shtetases Elda Dinaj (*kërkuesja*).

3. Sipas prokurorisë, në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar lidhja e ish-bashkëshortes së deputetit nën hetim me këtë pasuri, është krijuar dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se kjo është një pasuri e fshehur dhe objekt material i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 137 akti, datë 23.03.2023, ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive edhe për pasurinë e pretenduar nga kërkuesja, me qëllim

që të pengohet çdo transferim i mundshëm i saj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me urdhrin nr. 62, datë 26.04.2023, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas asaj gjykate, kontrata e blerjes së vilës, si edhe pagesa e parë e kështit janë veprime për kalimin e pronësisë kërkueses dhe janë kryer në bashkëpunim me deputetin nën hetim dhe ish-bashkëshorten e tij, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie. Ndaj këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se vendimet gjyqësore janë marrë në kundërshtim me ligjin procedural penal.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1310, datë 27.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se vendimet e gjykatave të posaçme janë marrë në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale, referuar kushteve të përcaktuara në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), zbatimi i së cilës është argumentuar mjaftueshëm nga gjykatat e posaçme.

6. Në datën 15.12.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të kërkesës. Me vendimin e datës 05.02.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 08.02.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi përmbajtja e dispozitave procedurale që rregullojnë sekuestron preventive nuk ka parashikuar mënyrë të veçantë gjykimi, ndaj seanca gjyqësore e datës 23.03.2023 në GJKKO-në e Shkallës së Parë duhej të ishte zhvilluar duke respektuar procedurën e njoftimit dhe thirrjes së personave që mund

të prekeshin nga kërkimi i prokurorit në të drejtat e tyre të pronësisë, si dhe t'u jepte mundësinë që paraprakisht të paraqisnin prova në mbrojtje të interesave të tyre. Sipas arsytimit të urdhrit të GJKKO-së së Apelit gjykimi i kërkesave të prokurorisë për sekuestrimin e pasurive në procesin penal bëhet në dhomë këshillimi si në shkallë të parë dhe në apel, por kjo gjykatë nuk përcakton se cila dispozitë konkrete procedurale e parashikon kufizimin e personave të prekur për të qenë pjesëmarrës në seancë gjyqësore. Kjo gjykatë ka refuzuar të administrojë prova të mbrojtjes, duke aluduar për pamundësinë e marrjes së provave nga palët private. Gjykata e Lartë nuk duhej të kishte pranuar faktin që GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit. Vendimi i GJKKO-së së Apelit bie ndesh me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi kjo gjykatë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel dhe ka rënduar pozitën e kërkueses. Kjo gjykatë duhej të kufizohej në shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së shkallës së parë brenda shkaqeve të ankimit.

- 7.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e posaçme në lidhje me caktimin e masës së sigurimit pasuror kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme. Përpos faktit se nuk mund të ketë masë sigurimi pa pasur person nën hetim, masa e sigurimit pasuror nuk duhej vendosur duke paraqitur thjesht një shpjegim të normës penale në mënyrë abstrakte. GJKKO-ja e Apelit, në mungesë të plotë të arsytimit, ka refuzuar të administrojë provat e paraqitura nga përfaqësuesi ligjor i kërkueses, duke aluduar për pamundësinë e marrjes së provave nga palët private. Kjo gjykatë ka zhvilluar një gjykim tërësisht formal, të paragjykuar dhe në shkelje të parimeve bazë procedurale, çka e bën të papranueshëm arsyetimin përfundimtar. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkueses për të drejtën e pronësisë mbi sendin për të cilin është vendosur sekuestroja. Po në këtë drejtim, gjykatat nuk kanë analizuar veprimtarinë konkrete të kërkueses, problematikën e çështjes dhe tërësinë e provave. Gjykatat e posaçme kanë gabuar në aplikimin e ligjit, duke lejuar shkelje të rënda të të gjithë procedurës së parashikuar nga legjislacioni për vënien e masave pasurore në procedurën penale. Ndryshe nga sa pretendohet nga Prokuroria e Posaçme dhe sa është arsyetuar nga gjykatat, kërkuesja nuk ka pasur dijeni për veprimtarinë e

dyshuar si kriminale të ish-funksionarit dhe ish-bashkëshortes së tij. Ajo ka vepruar në mirëbesim kur ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me shoqërinë “Inerte Express” sh.p.k. për blerjen e vilës. Gjykatat nuk kanë bërë analizë të provave në drejtim të evidentimit të origjinës së pronës dhe të të drejtave që kërkuesja gëzon në lidhje me këtë pronë. Verifikimi i saktë i pronësisë së sendit merr rëndësi të veçantë në rastin konkret, pasi përveç deputetit nën hetim asnjë nga personat e tjerë të përfshirë nuk janë palë në procedimin penal ndaj tij.

7.2. *Së drejtës së pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi vendosja e sekuestros preventive ndaj pasurisë së kërkueses përbën një ndërhyrje joproporcionale dhe të papërligjur në të drejtën e saj të pronës, duke e privuar nga të gjitha tagrat dhe jo vetëm nga disponimi i sendit. Kjo pasuri nuk është produkt i mundshëm i ndonjë vepre penale, as krijon mundësi për vepra të tjera të mundshme apo shtim të pasojave penale. Në rastin konkret nuk është paraqitur një lidhje e qartë midis sendit të vendosur nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet. Objekti është ndërtuar në respektim të ligjit dhe pronësia e kërkueses ka kaluar nëpërmjet një transaksioni të ligjshëm përpara noterit publik. Nga vendimet gjyqësore nuk rezulton që kontrata të ketë qenë fiktive ose me qëllim mashtrimin e ligjit, përkundrazi kërkuesja ka përmbushur detyrimet e saj. Prokuroria dhe në vijim gjykata e kanë vendosur kërkuesen *de facto* në pozitë të personit nën hetim, për pasojë vendimi i sekuestros preventive është një masë ekstreme për sa kohë kërkuesja disponon burime të ligjshme për blerjen e pasurisë dhe nuk ka asnjë komunikim me deputetin nën hetim. Masa e sekuestros është vendosur mbi supozime, sepse ish-bashkëshortja e këtij shtetasi është kujdesur për mobilimin e vilës. Organi i akuzës ka paraqitur në rrugë abstrakte mundësinë e konsumimit të veprës penale të korrupsionit pasiv apo pastrimit të produkteve të veprës penale, por nuk ka paraqitur një tablo të qartë për faktin se si kërkuesja mund të ketë lidhje me kryerjen e kësaj vepre penale në mënyrë direkte ose indirekte.

8. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

- 8.1. Kërkuesja nuk legjitimohet për kundërshtimin e masës së sekuestros, pasi pronari i sendit në atë kohë ka qenë subjekti “Green Coast” dhe e vetmja kontratë ligjërish e vlefshme është ajo midis këtij subjekti dhe shoqërisë “Inerte Express” dhe kjo e fundit nuk ka gëzuar titullin “pronar” në momentin e nënshkrimit të kontratës. Nga të gjitha të dhënat e administruara ngrihet dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se kërkuesja është thjesht një emër i vendosur për të fshehur pronarin e vërtetë të vilës nr. 73. Kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e sekuestros kur jo vetëm nuk ka bërë pagesën e plotë, por nuk i ka kaluar as e drejta e pronësisë së vilës. Për më tepër, ajo ka kryer pagesë në një kohë që sendi është vendosur nën sekuestro.
- 8.2. Në lidhje me pretendimin për *cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, sipas nenit 274 të KPP-së gjykata urdhëron sekuestrimin mbështetur në kërkesën e prokurorit. Duke qenë një masë sigurimi, që tipar kryesor të saj ka kufizimin e sendit, në mënyrë që në lidhje me këtë send të mos kryhen veprime të tjera, por të arrihet ngrirja e tij në gjendjen fizike dhe juridike në të cilën ndodhet, elementi i befasisë është kryesori. Në rast se do të zhvillohet seanca në praninë e palës do të shkaktohet rreziku i transferimit të të drejtave për sendin të persona të tretë pa lidhje me aktivitetin kriminal. Kërkuesja është pyetur dhe është dëgjuar në lidhje me pretendimet e ngritura dhe në ndërthurje me provat e administruara pretendimet e saj kanë rezultuar të pabazuara. Asaj nuk i është mohuar aksesit në gjykatë, pasi edhe pretendimet në lidhje me dorëzimin e provave, ato që ajo ka dashur të dorëzojë në apel, janë dorëzuar në vijim në organin procedues dhe nuk rezulton se ato kanë sjellë ndonjë ndryshim të situatës. Për më tepër, gjatë procesit penal gjykata administron vetëm provat e nevojshme.
- 8.3. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e standardit të arsytimit të vendimit*, gjykatat kanë analizuar momentet në të cilat kërkuesja pretendon se ka vendosur marrëdhënie kontraktore me pasurinë e paluajtshme në ndërthurje me atë çfarë ka rezultuar realisht nga hetimi, në lidhje me posedimin dhe personin që e ka poseduar atë, që rezulton të jetë ish-bashkëshortja e deputetit nën hetim. Marrëdhëniet e kërkueses nuk mund të shihen në drejtim të sendit, por në drejtim të shoqërive

“Inerte Express” dhe “Green Coast” dhe çuditërisht asnjëra prej tyre nuk ngre pretendime në lidhje me këtë send. Duhet të ishte shoqëria “Green Coast” që mund të ngrinte ndonjë pretendim, pasi rezulton se ende nuk është paguar për këtë send. Bindja e brendshme e gjyqtarit në arsyetimin e vendimit nuk mund të çojë *apriori* drejt pretendimeve për paanshmërinë e tij ose prezumimin e pafajësisë.

- 8.4. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* në drejtim të faktit se nuk provohet një lidhje e qartë midis sendit të vendosur në sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet personi nën hetim është i pabazuar, duke pasur parasysh qoftë dhe vetëm faktin se kontrata është lidhur në një datë kur kërkuesja nuk ka qenë në Shqipëri. Sendi shfaqet i qartë në lidhje me veprat penale që dyshohet të kenë kryer deputeti nën hetim dhe ish-bashkëshortja e tij, pasi ka dyshime se është objekt konkret i përfituar nga vepra penale e korrupsionit dhe për të cilin janë marrë të gjitha masat për të mbuluar këtë produkt, pronësinë e tij dhe mënyrën e fitimit të tij ose edhe shpenzimet e kryera në lidhje me investimet në këtë objekt. Pretendimi se vendosja e sekuestros preventive përbën një ndërhyrje të shpërpjesëtuar dhe të papërligjur në të drejtën e pronësisë, pasi gjykatat e kanë privuar nga të gjitha tagrat e pronësisë dhe jo vetëm nga disponimi i sendit (të cilin kërkuesja gjithsesi e kishte të pamundur për shkak të qenies së tij jashtë qarkullimit civil), është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, pretendohet se vila nuk ishte e regjistruar ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ndërsa, nga ana tjetër, ngrihen pretendime se nuk nevojitet sekuestrimi fizik i vilës, ndërkohë që mund të vendoset shënim në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Kërkuesja ka pretenduar se është privuar nga të gjitha tagrat e pronësisë, kur në të vërtetë ajo nuk i gëzon këto tagra, pasi, sikurse citohet në kontratën e lidhur mes shoqërisë “Inerte Express” dhe “Green Coast”, si dhe pas daljes së certifikatës në emër të shoqërisë “Inerte Express”, ajo, brenda 30 ditëve, do të nënshkruante kontratën përfundimtare me kërkuesen. Në situatën e mospagimit të çmimit të shitjes së plotë pronar i vilës vijon të jetë shoqëria “Green Coast”, ndaj nuk konstatohet se çfarë e drejte pronësie i është shkelur kërkueses.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për legjitimimin e kërkueses*

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet në aspektin procedural, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues. Edhe pse kërkuësja nuk rezulton të ketë regjistruar pasurinë e sekuestruar në emrin e saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ajo ka lidhur me shoqërinë “Inerte Express” kontratën për kalimin e të drejtave reale për atë send, kontratë e cila është në formën e kërkuar nga ligji, prandaj ajo legjitimohet edhe në aspektin substancial për atë pjesë të vendimit që ka disponuar për objektin që pretendon të drejta pronësie (vila në kompleksin “Green Coast”, Palasë, Vlorë). Gjithashtu, pavarësisht se gjatë procesit ka pasur dyshime në lidhje me pronësinë reale të këtij sendi, për sa kohë që këto dyshime nuk janë provuar me një vendim përfundimtar të formës së prerë, ato nuk janë të mjaftueshme për të vënë në dyshim interesin e drejtpërdrejtë të kërkueses në çështjen e parashtruar. Për këto arsye, pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuësja nuk legjitimohet, pasi pronari i këtij sendi në momentin e vendosjes së sekuestros është subjekti “Green Coast” dhe ajo nuk ka vërtetuar pronësinë e saj mbi sendin e paluajtshëm, është i pabazuar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuësja ka pretenduar se ndonëse vendimi objekt kërkesë nuk është vendim përfundimtar që zgjidh themelin e çështjes,

për shkak të pasojave që ai sjell në të drejtat themelore të saj, duhet t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Sipas kërkueses, gjykimi i zhvilluar me nismë të çdo personi të tretë, i cili nuk është person nën hetim, për të mbrojtur të drejtën e pronësisë nga masa e sekuestros, ka tiparet e gjykimit të themelit, prandaj në lidhje me të drejtën e pronësisë ai është përfundimtar.

12. Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret Gjykata vëren se objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit me të cilat është vendosur masa e sekuestros preventive për pasurinë e paluajtshme, vilën e ndodhur në fshatin Palasë, Vlorë. Edhe pse Gjykata nuk e ka vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të këtyre lloj vendimesh, së fundmi ajo i ka përfshirë në juridiksionin e saj me arsyetimin se përjashtimi i vendimeve të caktimit të masës së sekuestros nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të mbrojtjes së të drejtave substanciale të individit, ndërkohë që ankimi kushtetues individual synon të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit (*shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të këtij qëndrimi, Gjykata çmon se vendimi i caktimit të sekuestros, ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendos për themelin e çështjes, ndërhyt në të drejtat kushtetuese individuale, siç është ajo e pronës dhe kjo ndërhyrje vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Për rrjedhojë, ai konsiderohet me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues, për sa kohë pretendimet ndaj këtij vendimi kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave substanciale kushtetuese. Në këtë kuptim, në rastin konkret, kërkuësja i ka shteruar pretendimet e saj në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë ajo e ka përmbushur edhe këtë kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga

konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka vlerësuar se data e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë ajo konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.07.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 15.12.2023. Bashkëlidhur kërkesës përfaqësuesi ligjor i kërkueses ka paraqitur shkresën nr. 6287/1 prot., datë 05.12.2023 të Gjykatës së Lartë, përmes së cilës rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare në datën 18.10.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë të fundit si data nga e cila ka filluar afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, kërkuësja legjitimohet *ratione temporis*.

17. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe cenimin e së drejtës së pronës. Gjykata, duke pasur në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila i ka trajtuar vendimet e sekuestrimit kryesisht në këndvështrim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, ka theksuar se, në të tilla raste, ajo mund të ndalet rast pas rasti edhe në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të trajtojë aspektet e tjera procedurale të lidhura me të drejtën për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, por do t'i trajtojë ato si aspekte procedurale të së drejtës së pronës së garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës

18. Sipas kërkueses, vendosja e sekuestros preventive përbën ndërhyrje joproporcionale dhe të papërligjur në të drejtën e saj të pronës, duke u privuar kështu nga të gjitha tagrat dhe jo vetëm nga disponimi i sendit. Kjo pasuri nuk është produkt i mundshëm i ndonjë veprë penale, as krijon mundësi për vepra të tjera të mundshme apo shtim të pasojave penale dhe nuk është paraqitur një lidhje e qartë midis sendit të vendosur nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet. Objekti në fjalë është ndërtuar në respektim të ligjit dhe pronësia e kërkueses ka kaluar nëpërmjet një transaksioni të ligjshëm përpara noterit publik dhe nga vendimet gjyqësore nuk rezultojnë kontrata të ketë qenë fiktive apo me qëllim mashtrimin e ligjit, përkundrazi kërkuësja ka përmbushur detyrimet e saj. Prokuroria dhe në vijim gjykata e kanë vendosur kërkuesen *de facto* në pozitë të personit nën hetim, për pasojë vendimi i sekuestros preventive është një masë ekstreme, për sa kohë kërkuësja disponon burime të ligjshme për blerjen e pasurisë dhe nuk ka asnjë komunikim me deputetin nën hetim. Masa e sekuestros është vendosur mbi supozime, sepse ish-bashkëshortja e deputetit nën hetim është kujdesur për mobilimin e vilës. Gjykatat e posaçme në lidhje me caktimin e masës së sigurimit pasuror kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkueses për të drejtën e pronësisë mbi sendin që është vendosur sekuestroja.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimi i kërkueses është kontradiktor, pasi, nga njëra anë pretendohet se vila nuk ishte e regjistruar ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ndërsa, nga ana tjetër, ngrihen pretendime përse është proceduar me sekuestrimin fizik të vilës, pasi mund të vendosej shënim në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Sipas këtij subjekti, kërkuësja pretendon se është privuar nga të gjitha tagrat e pronësisë kur në të vërtetë ajo nuk i gëzon këto tagra, pasi, siç citohet në kontratën e lidhur mes shoqërive “Inerte Express” dhe “Green Coast”, si dhe pas daljes së certifikatës në emër të shoqërisë “Inerte Express”, brenda 30 ditëve kjo e fundit do të nënshkruante kontratën përfundimtare me kërkuesen. Subjekti i interesuar ka parashtruar edhe se pronar i vilës rezultojnë të jetë ende shoqëria “Green Coast”, si dhe ajo është gëzuar nga ish-bashkëshortja e deputetit nën hetim, për rrjedhojë nuk konstatohet se çfarë e drejte pronësie i është shkelur kërkueses.

20. Gjykata ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, e drejta e pronës private është e garantuar dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik.

E drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës. Edhe sipas nenit 41 të Kushtetutës e drejta e pronës mund të kufizohet, duke përcaktuar si kriter garantues të këtij kufizimi interesin publik (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*)

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive edhe për pasurinë e paluajtshme të pretenduar nga kërkuesja, me arsyetimin se me kontratën e kalimit të të drejtave dhe detyrimeve nr. 1382. rep., dhe nr. 1010 kol., datë 13.04.2021 shoqëria “Inerte Express”, e përfaqësuar nga M.B., i ka transferuar kërkueses të drejtat reale mbi këtë pasuri, me sipërfaqe të përgjithshme 177.1 m² dhe sipërfaqe parcele 482.7 m². Sipas kësaj kontrate, në përfundim të punimeve të vilës dhe pas lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes mes shoqërive “Inerte Express” dhe “Green Coast”, si dhe pas daljes së certifikatës në emër të shoqërisë “Inerte Express”, brenda 30 ditëve kjo e fundit do të nënshkruante kontratën përfundimtare me kërkuesen. Vlera e shitjes është 300,000 euro, e cila do të likuidohej me këste në llogarinë bankare të palës shitëse brenda 1 viti nga data e nënshkrimit të kontratës. Sipas gjykatës, referuar të dhënave të sistemit TIMS, rezulton se kërkuesja ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe, gjithashtu, shoqëria “Inerte Express” ka vendosur të shesë vilën në fjalë në një shumë prej 87,731 eurosh më pak nga ajo që e ka marrë (*shih paragrafin 92 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Në përfundim, gjykata ka vlerësuar se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e sekuestros preventive është e bazuar në ligj dhe në prova, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se kjo pasuri është pasuri e fshehur dhe se është vendosur me të ardhura nga burime të paligjshme. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi se për këtë pasuri mund të merren masa me qëllim tjetërsimin e saj, ndaj duhet vendosur masa e sekuestros preventive me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm i pasurisë së paluajtshme (*shih paragrafin 108 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

22. Për ankimin e kërkueses GJKKO-ja e Apelit ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se kontrata e blerjes së vilës në fshatin Palasë, Vlorë, si edhe pagesa e parë e këstit janë

veprime për kalimin e pronësisë kërkueses, të kryera në bashkëpunim me deputetin nën hetim dhe ish-bashkëshorten e tij për fshehje ose mbulim të origjinës së paligjshme të kësaj pasurie. Sipas asaj gjykate, krijohet dyshimi i arsyeshëm se deputeti ka pastruar produktin e veprës penale të korrupsionit për këtë pasuri të paluajjtshme nëpërmjet transferimit ose zhvendosjes së të drejtave në lidhje me pasurinë, me qëllim fshehjen dhe mbulimin e origjinës së paligjshme të saj dhe se këto vepra penale janë kryer në bashkëpunim me së paku tre persona me marrëveshje ndërmjet tyre. Ai shtetas dyshohet se i ka kryer veprat penale për të realizuar përfitim material ose jomaterial, siç parashikon pika 4 e nenit 28 të KP-së dhe se bashkëpunimi dyshohet se është i paramenduar dhe i paralogaritur, pra nuk është formuar rastësisht (*shih faqet 20-21 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

23. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1310, datë 27.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, me arsyetimin se vendimet e gjykatave të posaçme janë marrë në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale penale, për sa u përket kushteve të përcaktuara në nenin 274 të KPP-së, dhe se zbatimi i kësaj dispozite është argumentuar mjaftueshëm prej tyre. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat kanë vlerësuar se disponimi i lirë i sendeve, i lidhur ngushtësisht me veprat penale të korrupsionit, krijon lehtësira për kryerjen e veprës tjetër penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe ekziston dyshimi se për këto pasuri mund të merren masa me qëllim tjetërsimin e tyre, ndaj vendosja e masës së sekuestros preventive ka si qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm (*shih paragrafin 30 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po sipas Kolegjit Penal, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka bërë një arsyetim korrekt, duke iu përmbajtur objektit të kërkesës së paraqitur nga prokurori, ndërsa GJKKO-ja e Apelit në shqyrtimin e ankimit nuk ka pasur parasysh kërkesat e nenit 425/1 të KPP-së. Pavarësisht se nuk pajtohet me një pjesë të arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, e cila ka akuzuar persona të tretë, emrat e të cilëve nuk rezultojnë të jenë regjistruar sipas nenit 287 të KPP-së dhe nuk kanë qenë palë në këtë proces penal, Kolegji Penal ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesja nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së (*shih paragrafët 33-36 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

24. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të

kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Sekuestrimi i pasurisë në kuadër të procedurave ligjore zakonisht lidhet me kontrollin e përdorimit të pronës dhe jo me privimin e saj (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se kontrolli i përdorimit të pasurisë nga autoritetet publike duhet të jetë i ligjshëm, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik. Po kështu, ndërhyrja duhet të vendosë një “ekuilibër të drejtë” midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës. Midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm. Ndërsa pranohet dyshimi i arsyeshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar. Masat e përkohshme të vendosura në kuadër të procedurave gjyqësore, të cilat i paraprijnë një konfiskimi të mundshëm, mund të shkaktojnë dëmtim të pronës, por në mënyrë që dëmi të jetë në përputhje me garancitë e lartpërmendura, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke zbatuar standardet e mësipërme në rastin konkret në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimet gjyqësore të cilat kanë pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sekuestros preventive kanë vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën e kërkueses për gëzimin e pasurisë së paluajtshme, konkretisht pasurinë vilë, mbi të cilën, bazuar në kontratën noteriale, shoqëria “Inerte Express” i ka transferuar të drejta reale kërkueses dhe se ka rezultuar e provuar se ka paguar edhe një pjesë të çmimit. Edhe pse kërkuësja nuk rezulton ta ketë regjistruar këtë pasuri në emrin e saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme, kjo nuk përbën shkak për të mos gëzuar të drejtat që i burojnë nga një kontratë e lidhur sipas qëllimit dhe formës së kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, për sa kohë që provohet se ka ardhur një kufizim në të drejtat e kërkueses, do të vlerësohet në vijim nëse ai plotëson kriteret kushtetuese të ndërhyrjes, pra nëse është bërë vetëm

me ligj, për interes publik ose për arsye të rëndësishme publike dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit.

27. Gjykata konstaton se masa e sekuestros është vendosur në kuadër të procedimit penal të filluar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë” dhe është bazuar në parashikimet e nenit 274 të KPP-së, i cili lejon sekuestrimin e sendit kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj apo të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata risjell në vëmendje se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, ndaj interesi publik është i prezumuar.

28. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis sekuestros dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, çmon të marrë në analizë disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së sekuestros, në kuptim të balancimit të të drejtave ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se Gjykata duhet të konsiderohet si mjete i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Për këtë qëllim, Gjykata do të ndalet në vlerësimin e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sekuestros, duke mbajtur në konsideratë shpejtësinë e procedurave, pra që ndërhyrja në të drejtën e pronës të zgjasë për një kohë të kufizuar, si dhe dëmin që vjen nga cenimi, i cili nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme.

29. Lidhur me nevojën e ndërhyrjes, Gjykata analizon nëse masa e marrë është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, pra të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal në kuadër të të cilit është marrë. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ndonëse pasuria nuk ishte ende e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të kërkueses, kontrata e lidhur prej saj ka sjellë premisa për ushtrimin e tagrit të së drejtës së gëzimit të sendit, si pjesë e së drejtës së pronës. Megjithatë, sikurse ka prapësuar subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, kërkuesja nuk e ka gëzuar

efektivisht asnjëherë sendin dhe, për më tepër, ajo nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të provonte se ka ushtruar të drejta të gëzimit mbi të, të cilat janë ndërprerë për shkak të vendosjes së masës së sekuestros preventive. Gjithashtu, sikurse rezulton nga vendimet gjyqësore, ekziston një dyshim i arsyeshëm se kjo pasuri është vendosur me të ardhura nga burime të paligjshme dhe se nuk është pasuri e kërkueses, por një pasuri e fshehur e deputetit nën hetim dhe ish-bashkëshortes së tij. Duke qenë se ekziston rreziku i tjetërsimit të kësaj pasurie, vendosja e masës së sekuestros preventive është bërë me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm deri në përfundimin e procesit penal në kuadër të të cilit është marrë kjo masë.

30. Lidhur me përshtatshmërinë e masës, në vlerësimin e Gjykatës masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të përfshirë, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme. Gjykata, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore në të cilat arsyetohet se ka dyshime të arsyeshme se vila është një pasuri e fshehur dhe është objekt material i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, vlerëson se kjo masë është e përshtatshme dhe jo përtej asaj që është e pashmangshme. Ndërkohë nuk rezulton që kërkuesja të ketë kundërshtuar kohëzgjatjen e procedurave, prandaj Gjykata nuk do të ndalet për këtë kriter.

31. Lidhur me ashpërsinë e masës së sekuestros, Gjykata vlerëson se ajo analizohet në raport me të tria tagrat e së drejtës së pronës, përkatësisht: posedimin, gëzimin (ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj) dhe disponimin. Gjykata thekson se në çdo rast vendimet për caktimin e masës së sekuestros duhet të përcaktojnë se cilin tagër të së drejtës së pronësisë do të prekin përtej disponimit të lirë të sendit, rreziku për ndodhinë e të cilit duket të jetë synimi kryesor dhe i shprehur i nenit 274 të KPP-së. Në këtë drejtim masa e sekuestros është e lidhur me objektivin që konsiston në parandalimin e pasojave të mëtejshme të veprës penale.

32. Në rastin konkret, edhe pse masa e sekuestros kufizon të drejtat reale të kërkueses për pasurinë e paluajtshme Gjykata, mban në vëmendje faktin se pasuria ndaj së cilës është vendosur masa e sekuestros nuk përdoret nga kërkuesja për të përmbushur nevojat e strehimit të saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të provojë masën e dëmit që i shkaktohet nga sekuestrimi, si dhe rrezikun real dhe të drejtpërdrejtë që mbetet nga sekuestrimi i pronës së paluajtshme, pra në drejtim të ashpërsisë së masës nuk ka argumentuar që masa e sekuestros preventive është e tillë që të vendosë në dyshim proporcionalitetin e saj. Edhe pse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar në lidhje me proporcionalitetin e masës së

sekuestros së vendosur ndaj kërkueses, barra e provës i takonte kësaj të fundit për të vërtetuar se masa e vendosur, në këndvështrim të natyrës së veprës penale, është e ashpër në atë masë që tejkalon kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes.

33. Në përmbledhje të sa më sipër, Gjykata vlerëson se masa e sekuestros preventive: (i) e justifikon nevojën e ndërhyrjes, sepse synon të pengojë çdo transferim të mundshëm të pasurisë me qëllim që të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal; (ii) është e përshtatshme se mbetet një mjet me natyrë të përkohshme që balancon në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme qëllimin e procedimit penal me interesat e kërkueses; (iii) nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet, sepse kufizimi i së drejtës së kërkueses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë e saj vendoset përballë objektivit për parandalimin e kryerjes së mëtejshme të veprës penale. Për këto arsye, Gjykata çmon se midis vendimit së sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së kërkueses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë e saj është në raport të drejtë me gjendjen që ka diktuar nxjerrjen e tij.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,¹

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.04.2024

Shpallur më 16.05.2024

¹ Gjyqtarët Elsa Toska, Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për rrëzimin e kërkesës me të njëjtën linjë argumentimi të shprehur në mendimet paralele të vendimit nr.18, datë 19.03.2024.

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Elda Dinaj, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 137, datë 23.03.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrit nr. 62, datë 26.04.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2023-1310, datë 27.07.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ndaj, në vijim, do të parashtoj argumentet që mbështesin qëndrimin tim në këtë çështje.

2. Nga shqyrtimi kushtetues i çështjes rezulton se në kuadër të një procedimi penal ndaj një deputeti të dyshuar për kryerjen e disa veprave penale, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sekuestros preventive për dy pasuri të paluajtshme. Një ndër këto pasuri rezulton se është porositur nga shoqëria “Inerte Express” sh.p.k. e më pas me kontratën noteriale të kalimit të të drejtave dhe detyrimeve të datës 13.04.2021 i ka transferuar të drejta reale për pasurinë kërkueses Elda Dinaj. Prokuroria ka krijuar dyshime të arsyeshme se prona është një pasuri e fshehur dhe objekt material i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprave penale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive edhe për pasurinë e pretenduar nga kërkuesja, me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm i saj, vendim i cili është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit. Kërkuesja ka paraqitur rekurs kundër këtij vendimi, për të cilin Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqet e përcaktuara në nenin 274 të KPP-së.

3. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së pronës. Për këtë të fundit kërkuesja ka pretenduar se vendosja e sekuestros preventive përbën një ndërhyrje joproportionale dhe të papërligjur në të drejtën e saj të pronës, duke u privuar nga të gjitha tagrat dhe jo vetëm nga disponimi i sendit dhe se kjo masë është vendosur mbi supozime (*shih paragrafin 7.2 të vendimit*), duke mos u arritur të provohet lidhja me veprën penale të hetuar.

4. Shumica, në këndvështrim edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, për vendimet e sekuestrimit ka vendosur t’i trajtojë pretendimet e kërkueses vetëm në drejtim të së drejtës së

pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (*shih paragrafin 17 të vendimit*). Ajo ka arsyetuar se ndonëse rezulton se pasuria nuk është regjistruar në emrin e kërkueses në regjistrin e pasurive të paluajtshme, kjo nuk përbën shkak për të mos gëzuar të drejtat që i burojnë nga një kontratë e lidhur sipas qëllimit dhe formës së kërkuar nga ligji dhe, për rrjedhojë, ka vijuar me analizimin e kriterëve kushtetuese të ndërhyrjes, pra nëse është bërë vetëm me ligj, për interes publik, ose për arsye të rëndësishme publike dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Sipas shumicës, masa e sekuestros preventive përmbush dy kriteret e para, pasi është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik (*shih paragrafin 27 të vendimit*). Edhe për sa i përket kriterit të proporcionalitetit, shumica ka arritur në përfundimin se e justifikon nevojën e ndërhyrjes, është e përshtatshme dhe nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet (*shih paragrafin 33 të vendimit*).

5. Përkundër vlerësimit të shumicës, ndonëse bashkohem me analizën e dy kriterëve të para të ndërhyrjes në të drejtën e pronës, se është bërë me ligj dhe për interes publik, ndaj qëndrim ndryshe, për sa i përket proporcionalitetit të masës së sekuestros, në rastin konkret.

6. GJEDNJ-ja ka pohuar se në rastin e vendimeve të caktimit të masave të sekuestros ose konfiskimit për pasurinë e personave të tretë, të cilët nuk janë pjesë e procedimit penal, për të përcaktuar ekuilibrin midis qëllimit të ligjshëm dhe të drejtave themelore të kërkuesit, ekuilibri i drejtë varet nga shumë faktorë, ndër të cilët edhe sjellja e individit që ka të drejtën e pronës. Prandaj, gjykatave u lind detyrimi për të përcaktuar shkallën e fajit ose kujdesit që ka pasur kërkuesi ose, të paktën, marrëdhënien midis sjelljes së tij dhe veprave penale të kryera (*shih Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 24.10.1986, § 54; Silickiene kundër Lituanisë, datë 10.04.2012, §66*).

7. *Së pari*, çmoj se gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë në mënyrë shteruese të gjitha elementet e dyshimit të arsyeshëm, që konsiderohet i domosdoshëm për vendosjen e masës së sekuestros, në kushtet kur ajo kërkohet për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. Për shkak të natyrës së veprës penale, hetimi paraqet karakteristika të veçanta, pasi pasuria e cila dyshohet se është produkt i kësaj vepre, nuk është menjëherë e identifikueshme. Ndonëse është me rëndësi thelbësore lufta kundër këtyre veprave penale, të cilat dëmtojnë interesat shtetërorë dhe sistemin financiar, autoriteteve publike u lind detyrimi për të realizuar një hetim të drejtë dhe të thelluar në mënyrë që të mos cenohen të drejta substanciale të individëve të tretë të cilët nuk janë të përfshirë në aktivitete të paligjshme dhe kanë vepruar *bona fide*.

8. Në këtë drejtim, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të gabuar, ka vlerësuar se kërkuesja nuk konsiderohet pronare e pasurisë dhe ajo nuk e ka gëzuar titullin pronar në momentin e nënshkrimit të kontratës. Në analizë të fakteve dhe dokumenteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se kërkuesja ka lidhur një kontratë noteriale për kalimin e të drejtave me shoqërinë “Inerte Express”, çka nënkupton se ai është momenti kur, bazuar në dispozitat e kësaj kontrate, asaj i lind edhe e drejta e gëzimit dhe disponimit të pronës, ndonëse ende nuk ka kaluar pronësia mbi sendin. Në vlerësimin tim, gjykatat e posaçme nuk kanë bërë një verifikim të plotë të tagrave që gëzonte kërkuesja për pronën për të cilën është vendosur sekuestroja dhe nuk kanë analizuar nëse veprimet e saj janë kryer ose jo në mirëbesim.

9. *Së dyti*, vlerësoj se masa e sekuestros për pasurinë e kërkueses e tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi ndalimi tërësor i tagrave që ajo ka për pasurinë, pra disponimi dhe gëzimi i janë kufizuar tërësisht nëpërmjet vendosjes së kësaj mase. Edhe parashikimi i nenit 274 të KPP-së kërkon ndalimin e disponimit të lirë të një sendi në rast se ai mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Në kushtet kur sendi mbi të cilin është vendosur sekuestro preventive ishte jashtë qarkullimit civil, pasi ende nuk ishte regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, nuk arrin të provohet se disponimi i lirë i tij do të sillte pasoja.

10. Sikurse ka pranuar edhe shumica, gjykatat nuk kanë arsyetuar në lidhje me proporcionalitetin e masës së sekuestros së vendosur ndaj kërkueses, ndonëse ky detyrim u lind për shkak të natyrës së gjykimit të juridiksionit të zakonshëm, i cili bazohet në prova dhe fakte konkrete (*shih paragrafin 32 të vendimit*). Gjithashtu, në këtë drejtim, gjykatat nuk kanë arsyetuar as se përse masa e sekuestros konsiderohet si masa e vetme për mbarëvajtjen e procesit penal, në kushtet kur ekzistojnë edhe masa të tjera më të lehta, të cilat do t'i mundësonin asaj gëzimin e disa tagrave të pronës, duke siguruar njëkohësisht edhe zhvillimin e procesit penal të themelit, por janë mjaftuar vetëm me një arsyetim formal të kushteve dhe kriterëve për vendosjen e masës së sekuestros. Në këndvështrim të kriterit të proporcionalitetit, gjykatat e posaçme mund të urdhëronin bllokimin e të gjitha veprimeve juridike për pasurinë, për sa i përket tjetërsimit të persona të tretë, por duke lejuar disponimin efektivisht ose gëzimin e sendit deri në përfundimin e procesit penal.

11. Nën dritën e argumenteve të mësipërme, vlerësoj se masa e sekuestros preventive për pasurinë e kërkueses nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit, pasi ajo është një masë e ashpër

dhe gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë se përse në rastin konkret mbizotëron interesi për mbarëvajtjen e procesit penal përkundrejt atij të kërkueses.

12. Në përfundim, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës së pronës janë të bazuara, prandaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

Anëtare: Sonila Bejtja